



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 09.06.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9,10 dhe 31 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe Përfundimit nr. 06-31800-5/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt: 07.05.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e cila është e ndërlidhur me kërkesën e Këshillit organizativ të Brigadës 137 Gjakova e UÇK-së, për mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve të 7 Majit, Ditës së Epopesë së Çabratit, me dt: 09.06.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e cila është e ndërlidhur me kërkesën e Këshillit organizativ të Brigadës 137 Gjakova e UÇK-së, e evidentuar me nr. 01-015-27520 e dt: 15.04.2015, për mbështetje financiare të aktiviteteve të dt: 7 Maj 2015, kushtuar Ditës së Epopesë së Çabratit dhe për realizimin e një drame me tematikë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1.000€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të zotoj mjetet financiare në vlerë prej 1.000€, nga pozicioni i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e koordinatores së Këshillit organizativ të Brigadës 137 Gjakova, znj. Shkëndije Hoda, nr. 2018000036400007 –Teb Bank .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Znj. Shkëndije Hoda, koordinatore e Këshillit organizativ të Brigadës 137 Gjakova e UÇK-së
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila